

# Perceptimi publik i Gjykatës Speciale të Kosovës

Rreziqet dhe mundësitë



# Përmbajtja

## Colophon

Autorë: Michael James Warren, Kushtrim Koliqi, Nenad Maksimović, Marlies Stappers

Publikuar nga: PAX, Holandë

Utrecht (Holandë), shtator 2017

## Mirënjohje

Ky raport paraqet një përpjekje bashkëpunimi nga stafi i PAX, Qendrës për Paqe dhe Tolerancë (CPT), Impunity Watch dhe Integra-s. Sondazhi i perceptimit publik u krye nga [UBO Consulting](#). Diskutimet në grupin e fokusit u implementuan nga CPT dhe Integra. Autorët duan ta falenderojnë Kujtim Kocin dhe ekipin e UBO Consulting.

## Rreth PAX

PAX është një organizatë holandeze e shoqërisë civile që tubon njerëz me guximin për t'i dalë zot paqes, duke punuar për të ndërtuar shoqëri dinjitoze, demokratike dhe paqësore anembanë globin. Në Kosovë, programi i PAX përfshin drejtësinë tranzicionale dhe ballafaqimin me të kaluarën, si dhe angazhimin afatgjatë në promovimin e marrëdhënieve të mira mes komuniteteve në veri.

[www.paxforpeace.nl](http://www.paxforpeace.nl) | [info@paxforpeace.nl](mailto:info@paxforpeace.nl)

## Rreth Qendrës për Paqe dhe Tolerancë

Qendra për Paqe dhe Tolerancë (CPT) është organizatë jofitimprurëse joqeveritare, e themeluar me qëllim të mbështetjes së forcimit të kapaciteteve të institucioneve vendore në komunat me shumicë serbe të Kosovës dhe avokimit të qeverisjes lokale transparente dhe kosto-efektive. CPT-ja fuqimisht avokon për krijimin e përfaqësimit të shëndoshë dhe efektiv të serbëve të Kosovës në të gjitha nivelet e qeverisjes, dhe për pjesëmarrjen aktive të serbëve të Kosovës në jetën politike dhe shoqërore në Kosovë.

[www.ngocpt.org](http://www.ngocpt.org) | [office@ngocpt.org](mailto:office@ngocpt.org)

## Rreth Integra-s

Integra është organizatë e formuar nga një grup njerëzish të zotuar që të kontribuojnë për mëkëmbjen dhe zhvillimin e Kosovës dhe të rajonit. Puna Integra-s udhëhiqet nga parimet e qeverisjes së mirë dhe gëzimit të plotë të të drejtave të njeriut, pavarësisht nga etnia, raca, feja, gjinia, orientimi seksual ose përkatësia politike, të cilat janë thelbësore për ndërtimin e një Kosove demokratike dhe tolerante, plotësisht të integruar në bashkësinë evropiane.

[www.ngo-integra.org](http://www.ngo-integra.org) | [info@ngo-integra.org](mailto:info@ngo-integra.org)

## Rreth Impunity Watch

Impunity Watch është organizatë jofitimprurëse ndërkombëtare e bazuar në Holandë që kërkon të promovojë përgjegjësinë për mizoritë në vendet e dala prej një të kaluare të dhunshme. IW kryen kërkime mbi shkaqet rrënjësore të mosndëshkimit dhe mbi pengesat për reduktimin e tij, që përfshin zërat e bashkësive të prekura, për të nxjerrë këshilla politikash të bazuara në hulumtime mbi proceset që synojnë të nxisin të vërtetën, drejtësinë, reparacionet dhe mospërsëritjen e dhunës.

[www.impunitywatch.org](http://www.impunitywatch.org) | [info@impunitywatch.org](mailto:info@impunitywatch.org)

|                                   |           |
|-----------------------------------|-----------|
| <b>Përmbledhje e përgjithshme</b> | <b>4</b>  |
| <b>Sfondi</b>                     | <b>7</b>  |
| <b>Metodologjia</b>               | <b>9</b>  |
| <b>Gjetjet kyçe</b>               | <b>10</b> |
| <b>Analiza dhe rekomandime</b>    | <b>22</b> |

# Përmbledhje e përgjithshme

**D**homat e Specializuara dhe Zyra e Prokurorit të Specializuar për Kosovën (më tej: Gjykata Speciale e Kosovës) janë një "gjykatë hibride" që synon t'i gjykojë rastet e krimeve të luftës kundër individëve të lidhur kryesisht me Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës (UÇK) në periudhën 1998-2000. Është pjesë e sistemit gjyqësor të Kosovës, por që selinë e ka në Hagë dhe për personel ka gjyqtarë e prokurorë ndërkombëtarë. Themelimi i kësaj gjykate duhet të kuptohet në dritën e kontekstit më të gjerë të ballafaqimit me të kaluarën në Kosovë, në të cilën disa përpjekje të tjera kombëtare dhe ndërkombëtare për t'i trajtuar krimet e luftës nuk i përmbushën pritshmëritë. Ndërsa puna e Gjykatës mund të sigurojë një masë drejtësie për viktimat dhe një formë të drejtpërdrejtë përgjegjësie për kryesit e krimeve, ndikimi i saj mund të kufizohet rëndë nga dinamikat politike dhe sociale brenda vetë Kosovës dhe të kuptuarit e kufizuar të publikut mbi qëllimin dhe gamën e saj. Rëta faktorë mund të kontribuojnë jo vetëm në dëmtimin e ndikimit potencial pozitiv të Gjykatës në shoqëri, por edhe të ushtrinë efekt destabilizues mbi Kosovën.

Që nga prilli 2017, për tre muaj në Kosovë u krye një studim i perceptimit publik me qëllim që të kuptohen më mirë sfidat kryesore me të cilat ballafaqohet Gjykata Speciale e Kosovës. Ky dokument e përmbledh atë hulumtim dhe ofron rekomandime për t'i adresuar rreziqet potenciale që dalin nga puna e Gjykatës dhe për përfitimin nga mundësia e forcimit të ndikimit të saj pozitiv në shoqëri.

Ky hulumtim identifikoi disa sfida kryesore që lidhen me perceptimin e publikut:

- ◆ Vetëdijesimi publik i Gjykatës Speciale të Kosovës është i ulët, meqë 60.4% të shqiptarëve dhe 59.2% të serbëve të Kosovës besojnë se nuk marrin informacion të mjaftueshëm për Gjykatën.
- ◆ Keqinformimi rreth Gjykatës Speciale të Kosovës është i përhapur, meqë (për shembull) 35.4% të shqiptarëve dhe 18.9% të serbëve, që e konsiderojnë veten të mirinformuar rreth Gjykatës, gabimisht besojnë se ajo do t'i ndjekë penalisht krimet që lidhen me korrupsionin dhe kapjen e shtetit.
- ◆ Shqiptarët e Kosovës në shumicë dërrmuese e shohin mandatin e Gjykatës për ndjekjen penale të krimeve të luftës dhe krimeve kundër njerëzimit që lidhen kryesisht me UÇK-në, si të padrejtë, meqë 76.4% kanë këtë besim.

- ◆ Ndërsa shumica (69%) e serbëve të Kosovës besojnë se nuk ka gjasa ose ka shumë pak gjasa që Gjykata Speciale e Kosovës të sjellë drejtësi për kryesit e krimeve të rënda të luftës, shumica (60%) e shqiptarëve besojnë se ka gjasa ose ka shumë gjasa që Gjykata Speciale ta arrijë këtë.
- ◆ Ndër shqiptarët, shumica (51%) janë të gatshëm të protestojnë nëse luftëtarët e UÇK-së akuzohen nga Gjykata Speciale e Kosovës dhe 36% janë të gatshëm të veprojnë për të parandaluar ndjekjen penale të pjesëtarëve të UÇK-së.
- ◆ Besimi i publikut në mbrojtjen e dëshmitarëve është i ulët, meqë shumica e serbëve (82.1%) dhe pothuajse gjysma e shqiptarëve (48.8%) besojnë se nuk është e sigurtë që dëshmitarët të dëshmojnë në Gjykatën Speciale të Kosovës.

Hulumtimi shpalosi edhe se, pavarësisht prej sfidave, shumica e shqiptarëve (64.8%) dhe e serbëve (53.2%) në Kosovë besojnë se është e rëndësishme të trajtohen të gjitha krimet e kryera, ose të pësura nga të gjithë civilët, gjatë dhe pas luftës së Kosovës më 1998-99.

Hulumtimi i perceptimit publik e bën të qartë se vetëdijesimi i publikut për qëllimin, mandatin dhe fushëveprimin e Gjykatës Speciale të Kosovës është i ulët, situatë kjo që ka mundësiuar përhapjen e keqinformatave, duke i rritur kështu mundësitë për një efekt "shokues" pasi të jenë lëshuar aktakuzat e para dhe duke i ulur gjasat e pranimit social të punës së Gjykatës në afat të gjatë. Për më tej, në kontekstin e tashëm dhe duke pasur parasysh përpjekjet e mëparshme ndërkombëtare dhe vendore për t'i trajtuar krimet e luftës që nuk i kanë përmbushur pritshmëritë, shumëkush nga bashkësia etnike shqiptare e sheh juridiksionin e Gjykatës Speciale të Kosovës si përzgjedhëse dhe të pjesshme, ndërkohë që shumëkush në komunitetin etnik serb mbetet skeptik se ajo mund të sjellë drejtësi lidhur me ato raste të krimeve të luftës, gjatëkohë të lëna mbas dore, viktimat e të cilave ishin kryesisht serbë. Kështu, ekziston rreziku që, nëse puna e Gjykatës rezulton në ndjekjen e suksesshme penale të anëtarëve të UÇK-së, të rritet perceptimi i shqiptarëve për anshmërinë antishqiptare në ndjekjen e rasteve të krimeve të luftës. Nga ana tjetër, nëse Gjykata nuk ia del t'i bëjë të paktën disa dënime, zhgënjimi i serbëve prej institucioneve të Kosovës mund të rritet. Të dy rezultatet do të kishin efekte negative mbi marrëdhëniet tashmë të tendosura mes komuniteteve shqiptare dhe asaj serbe, mbi përpjekjet për ta arritur pajtimin, dhe mbi stabilitetin politik e social të Kosovës.

Raporti përmbillet me rekomandime për aktorët kryesorë, me synimin që t'i adresojë disa nga rreziqet e identifikuar nga sondazhi i perceptimit publik. Rekomandimet synojnë ta forcojnë mundësinë që puna e Gjykatës Speciale të Kosovës të ketë ndikim pozitiv shoqëror dhe të përfshijë (por pa u kufizuar) si vijon:

- ◆ Dhomat e Specializuara dhe Zyra e Prokurorit të Specializuar për Kosovën, Qeveria e Kosovës, aktorët kyç të BE-së dhe ndërkombëtarë, si dhe shoqëria civile kosovare duhet të bashkëpunojnë për zhvillimin dhe zbatimin e një **programi efektiv, të bazuar në prova dhe të shënjestruar të informimit publik dhe të dialogut**, për t'i adresuar boshllëqet e informatave, kundërshtimin e keqinformimit dhe përnxitjen e të gjitha palëve të interesuara që të përdorin gjuhë të qëndrueshme në lidhje me Gjykatën, në mënyrë që të zbusin rrezikun e keqinterpretimit dhe të hutisë dhe të gjenerojnë pranimin e gjerë shoqëror të procesit dhe të rezultateve të tij.

- ◆ Mesazhet duhet të **përshtaten veçanërisht për anëtarët e bashkësive të ndryshme të Kosovës**, për shembull: nënvizimi i rolit të Gjykatës për t'u siguruar se "askush nuk është mbi ligjin" në mesazhet e synuara për shqiptarët, si dhe promovimi i parimit të llogaridhënies individuale për krimet e luftës dhe krimet kundër njerëzimit të kryera kundër civilëve, në mesazhet e synuara për serbët dhe pakicat e tjera.
- ◆ Dhomat e Specializuara dhe Zyra e Prokurorit të Specializuar për Kosovën duhet të vendosin një **prani domethënëse në jetën publike të Kosovës**, duke depërtuar përtej një strategjie të kufizuar të komunikimit publik që ta arrijnë dukshmërinë, besueshmërinë dhe komunikimin e dyanshëm që t'u mundësojë institucioneve dhe zyrtarëve të Gjykatës të ndikojnë pozitivisht te rrëfimet në shoqërinë kosovare që aktivisht promovojnë mirëkuptimin dhe pranimin e punës së Gjykatës në një kontekst më të gjerë.
- ◆ Qeveria e Kosovës duhet të investojë burime politike, burokratike dhe financiare në promovimin e një **kornize kombëtare për trajtimin e të kaluarës së luftës** që zbut perceptimet e përgjedhshmërisë dhe të padrejtësisë, duke e kanalizuar Gjykatën Speciale të Kosovës në raport me përpjekjet plotësuese vendore, kombëtare e rajonale për t'u marrë me të kaluarën e kohës së luftës në Kosovë, posaçërisht (por pa u kufizuar) me hartimin e një Strategjie Kombëtare për Drejtësinë Tranzicionale dhe në kontekstin e diskutimeve rreth Komisionit të propozuar për të Vërtetën dhe Pajtimin.◆

# Sfondi

Dhomat e Specializuara dhe Zyra e Prokurorit të Specializuar për Kosovën, të njohura gjerësisht si "Gjykata e Speciale e Kosovës"<sup>1</sup>, janë një "gjykatë hibride" e themeluar në vitin 2016 brenda sistemit gjyqësor të Kosovës, e ndodhur kjo në Hagë me gjyqtarë dhe prokurorë ndërkombëtarë për punonjës. Gjykata synon t'i gjykojë rastet e krimeve të luftës kundër individëve, të lidhura me Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), kryesisht shqiptarë etnike, që kanë ndodhur në periudhën 1998-2000 dhe të cilat u ngritën në raportin e Rëshillit të Evropës 2012 të hartuar nga politikani zviceran Dick Marty. Themelimi i Gjykatës Speciale të Kosovës duhet të kuptohet në kontekstin më të gjerë të ballafaqimit me të kaluarën në Kosovë, në të cilin disa përpjekje të tjera ndërkombëtare dhe vendore për t'i adresuar krimet e luftës (përfshirë punën e Tribunalit Penal Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë ose ICTY, si dhe hetimet penale nga UNMIK-u, Misioni i BE-së për Sundimin e Ligjit në Kosovë dhe gjyqësori i Kosovës) nuk i përmbushën pritshmëritë. Shumë nga sfidat me të cilat Gjykatat Speciale e Kosovës ka gjasë të përballë kanë të bëjnë me këto dështime të mëparshme për ta sjellë drejtësinë e pritur për të gjitha viktimat dhe bashkësitë e prekura, dhe në përgjithësi, për mungesën e investimeve serioze në zgjidhjen e çështjeve ndëretnike dhe ndërshtetërore që pengojnë paqen dhe pajtimin në Kosovë dhe rajon, veçmas ato që lidhen me trashëgiminë e luftës së viteve 1998-99.

Kur të nisë puna e Gjykatës Speciale të Kosovës, ajo do ta ketë potencialin për të siguruar një masë drejtësie për viktimat dhe një formë të drejtpërdrejtë llogaridhënieje për kryesit e krimeve. Më gjerësisht, puna e Gjykatës mund të nxisë dialog kuptimplotë lidhur me faktet historike të periudhës së luftës dhe përfundimisht njohjen dhe pranimin më të gjerë të një dëshmie të përbashkët historike nga pjesëtarët e shumicës shqiptare dhe të pakicës serbe në Kosovë; të gjerojë respekt më të madh për sundimin e ligjit, duke i dhënë fund mosdëshkimit tek kryesit e pandehur; t'i pengojë incidentet e ardhshme të dhunës masive dhe shkeljeve të të drejtave të njeriut; dhe të kontribuojë për ta krijuar një mjedis të përshtatshëm për pajtimin midis komuniteteve të ndara. Këto efekte përmbledhtazi njihen si *ndikimi pozitiv shoqëror* dhe shpesh përbëjnë arsyetimin qendror, madje mbase fillestarin, për krijimin e mekanizmave gjyqësorë ndërkombëtarë si dhe hibridë, siç është Gjykata Speciale e Kosovës.<sup>2</sup>

PAX, Qendra për Paqe dhe Tolerancë (CPT), Impunity Watch dhe Integra bashkëzbatuan hulumtimin dhe analizën në këtë raport për të kontribuar në rritjen e ndikimit pozitiv shoqëror të Gjykatës Speciale të Kosovës dhe reduktimin e rreziqeve që paraqet puna e saj në marrëdhëniet ndërbashkësore dhe stabilitetet. Bazuar në analizën dhe rekomandimet e përshkruara në këtë raport, PAX, CPT, Impunity Watch dhe Integra do të organizojnë një rund fillestar të aktiviteteve të dialogut kombëtar dhe ndërbashkësor në fund të vitit 2017, duke

<sup>1</sup> Ndërsa Dhomat e Specializuara dhe Zyra e Prokurorit të Specializuar për Kosovën janë institucione të veçanta, ky raport aplikon terminologjinë e përdorur gjerësisht në Kosovë, duke iu referuar "Gjykatës Speciale të Kosovës" si njësi e vetme.

<sup>2</sup> Shih Impunity Watch 2013 Policy Brief Enhancing the Societal Impact of International Criminal Tribunals

plotësuar aktivitetet e komunikimit publik të Gjykatës Speciale të Kosovës, të Qeverisë së Kosovës dhe të palëve të tjera të rëndësishme ndërkombëtare, dhe duke kërkuar ta thellojnë dhe ta mbështesin përfshirjen e bashkësive të ndryshme të Kosovës me Gjykatën dhe punën e saj.

Ky raport synon të shërbejë si shoqërues i raportit të vitit 2017 të PAX dhe Impunity Watch, *Vlerësimi i Ndikimit Potencial të Gjykatës Speciale të Kosovës*, shkruar nga Gëzim Visoka, i cili ofron një analizë më të gjerë të sfondit, fushëveprimit dhe efekteve të mundshme të Gjykatës. ♦

# Metodologjia

Anketa e kryer në prill 2017 dha një portret sasior, gjithëpërfshirës dhe të detajuar të perceptimit publik në Kosovë mbi Gjykatën Speciale të Kosovës. Instrumenti i anketimit të familjeve përfshinte pyetje mbi mendimin e përgjithshëm rreth Gjykatës; njohjen e qëllimit dhe të fushëveprimit të Gjykatës, duke përfshirë keqkuptimet e rëndomta; perceptimin e të dhënave historike përkatëse; qëndrimeve mbi drejtësinë, legjitimitetin dhe efektet e mundshme të Gjykatës; ndryshimin në aprovim bazuar në të akuzuarit e mundshëm; njohurinë dhe qëndrimet përkatëse për çështjet e lidhura me drejtësinë tranzicionale; si dhe ndërlidhjet mes njohurive dhe qëndrimeve përkatëse për Gjykatën Speciale dhe çështjet shoqëruese të drejtësisë tranzicionale dhe ndryshoret e tjera kyçe. Mostra e anketës ka përfshirë 1356 njerëz mbi 18 vjeç, të të dy gjinive dhe nga të gjitha komunat e rajonet e Kosovës, duke mbuluar zonat urbane dhe ato rurale; mostra ka përfshirë 853 shqiptarë, 402 serbë dhe 101 pjesëtarë të komuniteteve të tjera etnike (turq, boshnjakë, goranë, romë, ashkalinj dhe egjiptianë). Mostra është përfaqësuese e ekonomive familjare në Kosovë, duke siguruar një diferencë gabimi prej +/- 2.66% në një interval besueshmërie prej 95%.


Rezultatet e anketës së perceptimit publik shërbyen si bazë për një varg prej 8 diskutimeve njëetnike të grupeve të fokusit, të kryera nga CPT dhe Integra në maj e qershor 2017, që synuan të jepnin njohuri më të thella mbi qëndrimet e publikut dhe reagimet e testimit prej respondentëve shqiptarë dhe serbë ndaj mesazheve të ndryshme mbi punën e Gjykatës. Pyetësi i grupit të fokusit përfshinte përpunimin e anketës së ekonomive familjare dhe e lehtësoi dialogun rreth mesazheve të ndryshme lidhur me qëllimin, ndikimin dhe kuptimin e punës së Gjykatës që mund ta forconte ndikimin pozitiv shoqëror. ♦

# Gjetjet kyçe

## Vetëdijesimi i publikut për mandatin e Gjykatës Speciale të Kosovës është i ulët

Anketimi i ekonomive familjare zbuloi se 30.7% e shqiptarëve e konsiderojnë veten të aspak të informuar rreth Gjykatës Speciale të Kosovës dhe 4.7% e konsiderojnë veten shumë të informuar. Ndër serbët, 42% e konsiderojnë veten të aspak të informuar, ndërsa 3% e konsiderojnë veten shumë të informuar. 60.4% e shqiptarëve dhe 59.2% e serbëve nuk besojnë se marrin informacion të mjaftueshëm për themelimin dhe rolin e Gjykatës Speciale.

Sa të informuar e konsideroni vetveten lidhur me Gjykatën Speciale të Kosovës?



Shumica e pjesëmarrësve në grupet të fokusit me shqiptarë treguan se ishin të vetëdijshëm për ekzistencën e Gjykatës, por nuk kishin mjaft informata për të shprehur ndonjë mendim konkret lidhur me mandatin ose fushëveprimin e punës së saj. Në përgjithësi, pjesëmarrësit ishin të vetëdijshëm se mandati i Gjykatës kishte të bënte me krimet e luftës, UÇK-në dhe raportin e Marty-t. Disa pjesëmarrës vunë në dukje se mungesa e informatave të disponueshme në media dhe gjetiu ndoshta është e qëllimshme: politikanët e Kosovës e dinë se informatat e sakta për mandatin e Gjykatës dhe të paditurit e mundshëm do të nxisin reagime negative nga qytetarët nëse informatat e tilla bëhen më të qasshme.

Në grupet e fokusit me serbë, madje edhe pjesëmarrësit që besonin se e njihnin mandatin e Gjykatës Speciale të Kosovës kuptuan se kishin keqkuptime kur përballeshin me fakte përkatëse; pothuajse të gjithë këta të anketuar, për shembull, besonin se mandati i Gjykatës ishte t'i ndiqte penalisht të gjitha krimet e pandehura të UÇK-së, jo vetëm ato të përvijuara në raportin e Marty-t. Të anketuarit pohuan se krimet e UÇK-së mbulohehin gjerësisht në mediat në gjuhën serbe, por se kishte shumë pak diskutim për faktin se veç individët (e jo vetë UÇK-ja) do të ndiqen penalisht për ato krime.

*“Ndonjë konferencë mediatike e aktorëve të përfshirë, ose ndonjë debat, tryezë e rrumbullakët, nuk mjafton. Duhet me shku në komuna e nëse nevojitet, në zona më të largëta, aktorët (deputetët, këshilltarët, kryeministri, etj.) për me bisedu me qytetarët, ashtu qysh bëjnë kur kërkojnë vota, dhe me informu publikun se për çka është puna, që qytetarët të informohen”.* (grua shqiptare)

*“Kemi dëgjuar vetëm fragmente të krejt rrëfimit. Ishin më shumë si lajme blic, sesa gazetari hulumtuese.”* (grua serbe)

## Reçinformimi rreth Gjykatës Speciale është i përhapur

Ndër të anketuarit që e konsiderojnë veten të informuar për Gjykatën Speciale të Kosovës, 91% e serbëve dhe 65% e shqiptarëve e kuptojnë se Gjykata do të ndjekë penalisht krimet e dyshuara të luftës dhe krimet kundër njerëzimit të kryera nga pjesëtarët e UÇK-së. Megjithatë, përhapja e këqinformimit të të gjithë të intervistuarit nga të dyja bashkësitë, të cilët vetëcilësohen të mirinformuar, pasqyron nivelin përgjithësisht të ulët të të kuptuarit të publikut.

*“Nuk kemi informacion të detajuar se me çka do të merret, përveç me krimet e luftës, e në detaje s’kemi informacion se sa ka me zgjatë procesi”.* (burrë shqiptar)


35.4% e shqiptarëve dhe 18.9% e serbëve që e konsiderojnë veten të mirinformuar për Gjykatën Speciale të Kosovës gabimisht besojnë se do t'i ndjekë penalisht krimet që lidhen me korrupsionin dhe krimet ekonomike. Vlen të përmendet se në disa grupe fokusi me shqiptarë, pjesëmarrësit shprehën bindjen se Gjykata Speciale e Kosovës do të ishte “një gjë e mirë” për Kosovën, sepse do ta “pastronte skenën politike” dhe do të sillte një brez të ri politikanësh të pakompromituar nga praktika të përhapura korrupsioni.

*“Nuk e dimë a po krijohet për krime lufte a për korrupsion; nëse është për korrupsion, do të ish në rregull, le t'i dënojë ata që e meritojnë. Por nëse merret ekskluzivisht me luftën, atëherë është diçka tjetër.”* (burrë shqiptar)


*“Nëse shpallet si gjykatë kundër korrupsionit, njerëzit do të pajtohen. Është këqinformim për me i mashtru njerëzit”.* (burrë shqiptar)

Gati gjysma (49.6%) e shqiptarëve dhe 44.6% e serbëve që e konsiderojnë veten të mirinformuar për Gjykatën Speciale të Kosovës gabimisht besojnë se mandati i saj përfshin ndjekjen e të gjithë atyre që kanë kryer krime lufte dhe krime kundër njerëzimit në periudhën 1998-2000, pavarësisht përkatësisë etnike të tyre. Ngjashëm, 32.8% e shqiptarëve dhe 15% e serbëve, që e konsiderojnë veten të mirinformuar, gabimisht besojnë se Gjykata do të ndjekë penalisht krimet e luftës dhe

**Cfarë lloj krimesh mendoni se do të mbulohen nga Gjykata Speciale të Kosovës?**



Gjykata Speciale e Kosovës ka mandat për të ndjekur penalisht krimet që lidhen me Raportin Marty 2011, i cili kryesisht përshkruan krimet e dyshuara që lidhen me Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës. A mendoni se Gjykata Speciale e Kosovës do të përqendrohet tek kryesit individualë, UÇK-ja si organizatë, apo te të dyja?



krimet kundër njerëzimit të kryera nga kryesit jugosllavë dhe serbë. Në fakt, meqë mandati i Gjykatës mbulon vetëm krimet e identifikuar në raportin e Marty-t, nuk ka gjasa ta ndjekë penalisht askë që nuk lidhet drejtpërdrejt me UÇK-në.

Së fundi, 33.9% e serbëve dhe 17.8% e shqiptarëve që e konsiderojnë veten të mirinformuar për Gjykatën Speciale të Kosovës gabimisht besojnë se ajo do ta ndjekë UÇK-në si organizatë, ndërsa 29.6% e serbëve dhe 24.4% e shqiptarëve gabimisht e besojnë se do t'i ndjekë penalisht kryesit individualë por edhe UÇK-në si organizatë. Në fakt, Gjykata Speciale e Kosovës nuk ka mandat për të hetuar ose ndjekur UÇK-në si organizatë, ose sjelljen e saj gjatë luftës.

*“Kjo duhet t’ia tregojë botës pastërtinë e vërtetë të UÇK-së ... Individët që kanë kry krimet do të përgjigjen individualisht.” (burrë shqiptar)*

*“Në përgjithësi, ata po e ndëshkojnë UÇK-në.” (grua shqiptare)*

*“Nuk më kujtohet ndonjë deklaratë e zëdhënësit të Gjykatës Speciale ose e kujto do që ka lidhje profesionale me Gjykatën. Kam hasë vetëm në deklarata të politikanëve, të cilët kanë interes të caktuar për ta portretizuar situatën në përputhje me interesat e tyre”. (burrë serb)*

**Shqiptarët në Kosovë kryesisht e perceptojnë Gjykatën Speciale të Kosovës si të padrejtë**


Ndër shqiptarët, 76.4% besojnë se është e padrejtë që Gjykata Speciale e Kosovës t’i ndjekë penalisht krimet e luftës dhe krimet kundër njerëzimit të përshkruara në raportin e Marty-t, i cili kryesisht mbulon krimet që lidhen me UÇK-në<sup>3</sup>; 15.0% e shohin këtë caktim si të drejtë, dhe 6% nuk ofruan përgjigje ose refuzuan të përgjigjeshin. Anketa vuri në dukje se perceptimi i padrejtësisë është shumë më i madh në mesin e të intervistuarve shqiptarë në rajonet Ferizaj, Pejë dhe të Mitrovicë; ndër të anketuarit më të arsimuar; dhe në mesin e 45-54-vjeçarëve.

Në grupet e fokusit, të intervistuarit shqiptarë përshkruan se e perceptojnë Gjykatën Speciale të Kosovës si të padrejtë, për shkak se ajo përqendrohet ekskluzivisht tek kryesit e pandehur shqiptarë të lidhur me UÇK-në, për shkak se përqendrimi në krimet e UÇK-së njollos dëshminë e një lufte të drejtë që u zhvillua në mbrojtje të civilëve dhe për shkak të gamës së krimeve të kryera në Kosovë nga Serbia dhe forcat serbe për të cilat nuk ka pasur pasoja të qarta ligjore. Për ata pjesëtarë shqiptarë të vetëdijshëm për lidhjen ndërmjet mandatit të Gjykatës Speciale të Kosovës dhe raportit të Marty-t, mendimi i përhapur se vetë Marty ishte i njëanshëm kundrejt UÇK-së dhe shqiptarëve, ka minuar besimin në drejtësinë e mundshme të Gjykatës. Pjesëmarrësit shprehën shqetësimin se shqiptarët nga Kosova nuk mund të aplikojnë për poste në Gjykatë, ndërsa qytetarët e Serbisë mundën.

Pjesëmarrësit shqiptarë ishin gjerësisht të pajtimit se legjislacioni i Kuvendit të Kosovës për themelimin e Gjykatës Speciale të Kosovës u miratua nën trysinë e jashtme. Në të vërtetë, 77.6% e shqiptarëve të anketuar pajtohen se trysnia nga aleatët ndërkombëtarë të Kosovës

<sup>3</sup> Vini re që kjo pyetje në anketë u parashtrua pasi të anketuarve iu paraqitën informatat themelore mbi mandatin e Gjykatës Speciale të Kosovës.

Gjykata Speciale e Kosovës do të ndjekë penalisht krimet e luftës dhe krimet kundër njerëzimit të përshkruara në Raportin Marty, i cili kryesisht mbulon krimet e pretenduara që lidhen me Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës. Si e shihni këtë caktim?



është arsyeja për themelimin e Gjykatës, ndërsa 23% pajtohen se presioni nga qeveria serbe është arsyeja. Të anketuarit shqiptarë në fokus grupe e konsideruan këtë imponim të dukshëm të Gjykatës nga fuqitë e jashtme si të padrejtë. Vlen të theksohet se 28.1% e shqiptarëve të anketuar u pajtuan se paaftësia ose mosgatishmëria e gjyqësorit të Kosovës, ICTY-së, Misionit të OKB-së në Kosovë (UNMIK) dhe Misionit të BE-së për Sundimin e Ligjit në Kosovë (EULEX) për t'i ndjekë penalisht figurat e larta të UÇK-së është arsyeja për themelimin e Gjykatës Speciale të Kosovës.

*“Mendoj se shumica e [të pandehurve të UÇK-së] janë gjyku në Hagë dhe nuk kanë dalë fajtorë, e nuk besoj se është dashur të themelohet një Gjykatë Speciale”.* (gruashqiptare)

*“Kjo është gjë e keqe, është e njëanshme; le të jetë njëjtë për shqiptarët si për serbët”.* (burrë shqiptar)

*“Imazhi i Kosovës do të shkatërrohet, UÇK-ja do të njolloset, kjo është fyerje për ne”.* (burrë shqiptar)

*“Shteti i Kosovës nuk ka dashtë me e ngritë Gjykatën Speciale dhe e detyroi BE-ja. Është një kusht për pranimin në BE, për marrjen e vizave”.* (grua shqiptare)

*“Vetë e kemi pru punën këtu, se nuk kemi qenë në gjendje me siguru një sistem gjyqësor të paanshëm a të pavarur”.* (burrë shqiptar)

Për krahasim, 45.5% e të intervistuarve serbë e shohin mandatin e Gjykatës Speciale të Kosovës si të drejtë, 41.5% si të padrejtë, dhe 12.9% nuk ofruan përgjigje ose refuzuan të përgjigjeshin. Përshtypja e përgjithshme e pjesëmarrësve në grupet e fokusit me serbë ishte se shumica shqiptare u detyrua nga bashkësia ndërkombëtare ta krijonte Gjykatën Speciale të Kosovës dhe se shtytja për këtë nismë nuk ishte dëshirë e vërtetë për ta parë drejtësinë, por nevojë e aleatëve ndërkombëtarë të Kosovës për t'i "pastruar duart" e klientëve politikë që dolën nga UÇK-ja dhe tani mbajnë pozita pushteti.

*“Mediat serbe po ... e paraqesin këtë si sukses për diplomacinë serbe”.* (burrë serb)


*“[Shqiptarët] vërtet besojnë se luftëtarët e UÇK-së nuk kanë vrarë civilë dhe fëmijë. Ata janë të indoktrinuar dhe të tronditur nga tregimet e heronjve dhe veprat e UÇK-së gjatë e pas luftës”.* (grua serbe)

## Serbët në Kosovë janë skeptikë se Gjykata Speciale e Kosovës mund të sjellë drejtësi për ata që kanë kryer krime të rënda lufte

Shumica (69%) e serbëve thonë se nuk ka shumë gjasa që Gjykata Speciale e Kosovës të sjellë drejtësi për ata që kanë kryer krime të rënda lufte më 1998-2000. Serbët janë veçmas skeptikë se kryesit e pandehur mund të kenë gjykim të drejtë në një gjykatë që vepron jashtë Kosovës me gjyqtarë e prokurorë ndërkombëtarë, meqë 67.4% thonë se kjo nuk është e mundshme (kundrejt 42.2% të shqiptarëve).

Shumica e pjesëmarrësve serbë përmendën se Gjykata Speciale e Kosovës është themeluar për shkak se asnjëri nga institucionet e mëparshme të ngritura për t'u marrë me krimet e luftës (duke përfshirë ICTY, EULEX dhe gjykatat e vendit) nuk kanë qenë në gjendje të arrijnë

Sa e gjasshme ose e pagjasshme, sipas mendimit tuaj, është që Gjykata Speciale e Kosovës të sjellë para drejtësisë ata që kanë kryer krime të rënda lufte në periudhën 1998-2000?





drejtësinë për viktimat serbe. Si rezultat i këtij modeli të dështimit, serbët etnikë kanë humbur besimin në sistemin gjyqësor në Kosovë – komponentët e tij vendorë dhe ndërkombëtarë ‘ të cilin e perceptojnë si të ndikuar nga korrupsioni, mungesa e kapaciteteve dhe pamundësia për t’u reformuar. Kjo humbje e besimit shtrihet në Gjykatën e Specialistëve të Kosovës, e cila nuk shihet si rrënjësisht e ndryshme nga ushtrimet e mëparshme të dështuara gjyqësore të lidhura me krimet e luftës.

*“Ne besojmë se Gjykata do të fillojë me rastet e ‘peshqve të vegjël’. Por të merret me kriminelët seriozë që deklarohen si heronj lufte nuk është e mundshme ose ata do të përfundojnë me dënime simbolike”. (burrë serb)*

*“Më mirë të mos ketë fare Gjykatë sesa të arrihet ndonjë drejtësi e pjeshme ose përzgjedhëse” (grua serbe)*

Në kontrast të thellë, 60% e shqiptarëve besojnë se ka gjasa ose ka shumë gjasa që Gjykata Speciale e Kosovës të sjellë drejtësi për ata që kanë kryer krime të rënda lufte. Ngjashëm me pjesëmarrësit e grupeve serbe të fokusit, pjesëmarrësit shqiptarë, të cilët shprehën skepticizëm se Gjykata Speciale e Kosovës mund të sjellë drejtësi për krimet e luftës, vunë në dukje përvojat e UNMIK-ut dhe EULEX-it, të cilat u treguan të paafta për të bërë përparim të dukshëm me krimet e luftës.


## Gatishmëria për të protestuar ndaj padive të Gjykatës Speciale të Kosovës është e lartë në mesin e shqiptarëve

Më se gjysma (51%) e shqiptarëve janë të gatshëm të protestojnë nëse luftëtarët e UÇK-së akuzohen nga Gjykata Speciale e Kosovës. Në rast se zyrtarët serbë në Kosovë ose zyrtarë të Republikës së Serbisë pohojnë se Gjykata Speciale e Kosovës dëshmon që UÇK ishte organizatë terroriste dhe veprimet e saj ishin të paligjshme, përqindja e shqiptarëve të gatshëm për të protestuar ngritet në 64.4%. Një përqindje e ngjashme e të anketuarve shqiptarë (64.7%) janë të gatshëm të protestojnë nëse i konsiderojnë vendimet kundër anëtarëve të UÇK-së të padrejta. Gatishmëria për të protestuar është shumë më e lartë në rajonet Ferizaj dhe Mitrovicë sesa në rajonet e tjera, dhe dukshëm më e lartë në mesin e burrave dhe të rinjve (18-25 vjeç).


41.4% e burrave shqiptarë janë të gatshëm të protestojnë edhe nëse dëshmitë tregojnë qartë fajësinë e ndonjë pjesëtari të akuzuar të UÇK-së për krimet që i ngarkohen. Anketa gjeti se një e treta (36%) e shqiptarëve janë të gatshëm të bashkohen me të tjerët për ta parandaluar Gjykatën Speciale të Kosovës, Qeverinë e Kosovës ose dike tjetër nga ndjekja penale e pjesëtarëve të UÇK-së. Kjo tregon që një pjesë më e vogël, ndonëse e mjaftueshme, e popullsisë është e motivuar për të shkuar përtej protestës drejt veprimit të drejtpërdrejtë që ndërhyjnë me ndjekjen penale të pjesëtarëve të UÇK-së.

Ndër shqiptarët, 38.9% janë më pak të gatshëm të protestojnë nëse udhëheqësit e bashkësisë ndërkombëtare flasin në favor të Gjykatës Speciale të Kosovës dhe nevojës për të treguar se askush nuk është përmbligj. 37.6% janë më pak të gatshëm të protestojnë nëse ish-komandantët e UÇK-së flasin njësoj. 28.6% e shqiptarëve etnikë janë më pak të gatshëm të protestojnë nëse paraqiten prova që vërtetojnë qartë fajësinë e pjesëtarëve të UÇK-së për krimet që u ngarkohen (ndërsa 32.9% thonë se dëshmitë e qarta nuk janë faktor lehtësues).

A do të ishit gati për të protestuar nëse ish-luftëtarët e UÇK-së paditen nga Gjykata Speciale e Kosovës?



A do të ishit gati për të protestuar nëse zyrtarët e qeverisë serbe pretendojnë se Gjykata Speciale e Kosovës dëshmon se UÇK-ja ishte organizatë e paligjshme dhe terroriste?



Pjesëmarrësit në grupet shqiptare të fokusit shprehën përkrahje të fortë personale për protestat, sidomos nëse gjykimet konsiderohen të padrejta, por ishin skeptikë se a do të mobilizoheshin qytetarët në numër të madh për protestë. Disa pjesëmarrës pohuan se keqinformimi është arsye e mundshme për protesta.

*“Personalisht, nuk do të shkoja në protesta. Përderisa u miratua në Kuvend, pse me shku në protestë?” (burrë shqiptar)*

*“Gjithçka që është në kundërshtim me kushtetutën e shtetit, kushdo që e njollos UÇK-në ose shtetin kisha me dalë pajtëtar me protestue kundër tyre.” (burrë shqiptar)*


Pjesëmarrësit e grupeve serbe të fokusit pohuan se nuk do të protestonin pas akuzave të lëshuara nga Gjykata Speciale e Kosovës, por të gjithë ishin të bindur se do të protestonin shqiptarët për të shprehur solidaritet me “krijuesit e shtetit” dhe se ato protesta mund të bëheshin të dhunshme. Pjesëmarrësit shprehën frikën se udhëheqësit politikë shqiptarë mund të përdorin gjuhën e urrejtjes për të motivuar sulme të dhunshme ndaj qytetarëve serbë dhe pronave të tyre, si hakmarrje për natyrën e perceptuar antishqiptare të aktakuzave. Pjesëmarrësit deklaruan edhe se zyrtarët në Beograd do t’i përdorin paditë dhe vendimet e Gjykatës Speciale të Kosovës për të fituar pikë në luftën e tyre diplomatike kundër njohjes ndërkombëtare të Kosovës dhe për qëllime politike të brendshme.

### Besimi i publikut në mbrojtjen e dëshmitarëve është i ulët

Shumica e serbëve (82.1%) dhe gati gjysma e shqiptarëve (48.8%) nuk besojnë se është e sigurtë për dëshmitarët të dëshmojnë në Gjykatën Speciale të Kosovës.

Në grupet shqiptare të fokusit kishte pajtim të gjerë se, mbasi Kosova është vend i vogël dhe qytetarët lidhen ngushtë me lidhje familjare e shoqërore, të pandehurit pothuajse gjithmonë do të jenë në gjendje të zbulojnë kush dëshmoi kundër tyre. Pjesëmarrësit në përgjithësi shprehën mendimin se dëshmitarët shqiptarë do të ngurrnin të dëshmonin për shkak të dy rreziqeve kryesore, përkatësisht: sepse do të etiketoheshin si tradhtarë dhe sepse do të ekspozoheshin ndaj kërcënimeve ose dhunës nga ata që shoqërohen me kryesit e pandehur. Institucionet shtetërore shihen si të paafta për të ofruar mbrojtje përkatëse për dëshmitarët. Pjesëmarrësit shprehën shqetësime edhe rreth dëshmimeve të rreme (“të paguara”), e Serbia u identifikua si një aktor që do të mund të ndikonte në dëshmitë. Disa pjesëmarrës nënvizuan se, megjë Gjykata Speciale e Kosovës do të “pastrojë” vendin prej njerëzve të korruptuar, dëshmitarët mund të ndjehen të lirë të shprehin.

A mendoni se është e sigurtë që dëshmitarët të dëshmojnë në Gjykatën Speciale të Kosovës?



*“Ata do të dëshmojnë, por mandej a jetojnë a jo?” (grua shqiptare)*

*“Unë nuk do të kisha guximin me dëshmu, se mendoj që mund të ndodhin shumë gjëra dhe nuk do të ndjehesha e sigurt me dëshmu. Të isha jashtë shtetit, kisha me dëshmu.” (grua shqiptare)*

Në grupet serbe të fokusit pati konsensus midis pjesëmarrësve se dëshmitarët nuk mund të mbahen të sigurt. Të gjithë pjesëmarrësit e grupeve të fokusit përmendën gjykimet ku një komandant i UÇK-së u lirua për shkak se dëshmitarët u vranë ose iu nënshtruan presionit për t’i rishikuar deklaratat.

*“Kosova është shumë e vogël, gjithkush e njeh gjithkënd, e dëshmitarët nuk mund të dëshmojnë pa u kuptuar kjo publikisht”. (gura serbe)*

*“Ndjenja e pasigurisë në Kosovë është mbizotëruese dhe ky perceptim bazohet në realitet.” (burrë serb)*

### Qomunitetet e Kosovës janë të ndara rreth mbështetjes së qeverisë për mbrojtjen e të akuzuarve

Ndër serbë, 68.7% thonë se Qeveria e Kosovës nuk duhet të ofrojë përkrahje financiare për mbrojtjen e të paditurve në Gjykatën Speciale të Kosovës. 17.2% thonë se Kosova duhet të ofrojë mbështetje financiare për mbrojtjen e të akuzuarve dhe 14.2% nuk e dinë.

Ndër shqiptarët, 57.7% thonë se Qeveria e Kosovës duhet të sigurojë përkrahje financiare për mbrojtjen e të akuzuarve, ndërsa 31.8% e kundërshtojnë këtë, e 10.6% nuk e dinë. Disa pjesëmarrës të grupeve shqiptare të fokusit theksuan se e konsideronin përkrahjen financiare të padrejtë; disa besonin se vetë Gjykata Speciale e Kosovës duhet të paguajë për kostot e mbrojtjes së të pandehurve. Për shumikë, përkrahja financiare për ata që shpallen të pafajshëm ishte e pranueshme, ndërsa përkrahja për ata që shpallen fajtorë ishte e papranueshme.

*“Ata janë pasuru, janë të korruptuar, kanë bërë pare, a ende të paguajmë për ta? Ky është gabim i madh.” (burrë shqiptar)*

### TV do të jetë mjeti më i rëndësishëm i komunikimit për proceset dhe gjykimet e Gjykatës Speciale të Kosovës

Pyetjes se cilat burime informacioni do të përdoren për t’i ndjekë proceset gjyqësore dhe gjykimet e Gjykatës Speciale të Kosovës, shqiptarët iu përgjigjën se TV (83%) dhe portalet në internet (36.7%) do të jenë më të rëndësishme, të pasuara nga mediat sociale (20.8%), faqja e Gjykatës Speciale të Kosovës (14.4%) dhe gazetatat (14%). Në mesin e serbëve, TV (58.5%) është më e rëndësishme, e pasuar nga gazetatat (24.4%), portalet online (19.7%), radioja (16.4%) dhe mediat sociale (16.2%) (4% e shohin faqen e internetit të Gjykatës Speciale të Kosovës si burim të rëndësishëm informacioni).

Pjesëmarrësit në grupet shqiptare të fokusit u pajtuan se TV ishte burimi më i rëndësishëm i informacionit për shumicën e qytetarëve, megjithëse disa pjesëmarrës theksuan se shumica

e mediave janë të lidhura me shtetin ose partitë politike dhe prandaj nuk mund t'u besohet. Burime të tjera përkatëse të informacionit që u përmendën nga pjesëmarrësit përfshinin personat që ishin viktimë të rasteve dhe dëshmitarët, gjykatësit, OJQ-të dhe udhëheqësit e opozitës. Disa pjesëmarrës u bënë thirrje atyre që e miratuan Gjykatën Speciale të Kosovës - pra, politikanëve - të japin informacion mbi qëllimin dhe aktivitetet e saj; të tjerët shprehën skepticizëm për ndershmërinë dhe besueshmërinë e zyrtarëve të zgjedhur për këtë çështje. Vlen të përmendet se edhe anketa e perceptimit publik, edhe diskutimet e grupeve të fokusit treguan se shqiptarët i shohin ish-komandantët e UÇK-së, si Presidenti Hashim Thaçi, si zërat më të besueshëm për çështjet që lidhen me Gjykatën Speciale të Kosovës.

*“Nuk na pëlqen me lexu dhe duam që informacioni të na shërbehet në pjatë”. (grua shqiptare)*

*“TV është burimi më i mirë i informacionit, sidomos edicionet e lajmeve. Arsyeja pse nuk u besojmë politikanëve është sepse janë shënjestër e kësaj gjykate dhe prandaj nuk mund të jenë shumë objektivë”. (grua shqiptare)*

Shumica e pjesëmarrësve të grupeve serbe të fokusit pohuan se i besojnë TV-së, pasi stacionet televizive (sidomos në rrjetet publike) shihen se kumtojnë informacione “të verifikuara dhe zyrtare”. Mediat sociale dhe raportet e OJQ-ve nuk konsiderohen burime të besueshme informacioni mbi Gjykatën Speciale të Kosovës, e OJQ-të në veçanti konsiderohen si të komprometuara nga fondet që marrin prej donatorëve ndërkombëtarë. Shumica e të anketuarve serbë pohuan se nuk i besojnë plotësisht asnjë politikani a kujtdo që ka interes të caktuar për të paraqitur informacione lidhur me mandatin dhe operationet e Gjykatës; megjithatë, profesionistët ligjorë nga Ministria e Drejtësisë e Serbisë ose nga vetë Gjykata e Speciale e Kosovës shiheshin si të besueshme.

## **Shumica e shqiptarëve dhe serbëve në Kosovë besojnë se është e rëndësishme të trajtohen të gjitha krimet e luftës**

Shumica e shqiptarëve (64.8%) dhe serbëve (53.2%) në Kosovë thonë se është e rëndësishme me u marrë me të gjitha krimet e kryera, ose krimet e vuajtura nga të gjithë civilët, gjatë dhe pas luftës së viteve 1998-99.

Në grupet shqiptare të fokusit, perceptimi se krimet serbe në Kosovë nuk u adresuan në mënyrë përkatëse pas luftës, ishte i përhapur. Shumë pjesëmarrës shqiptarë shprehën mendimin se Gjykata Speciale e Kosovës mund të ndihmojë “me e mbyllë librin” për krimet e dyshuara të luftës të kryera nga UÇK-ja një herë e përgjithmonë.

*“Është keq që po krijohet kjo ndarje etnike, përndryshe drejtësia duhet të mbizotërojë për çdo viktimë.” (grua shqiptare)*

Përshtypja e përgjithshme e pjesëmarrësve të grupit serb të fokusit ishte se të gjithë individët e përfshirë në vepra penale gjatë luftës duhet të ndiqen penalisht. Disa pjesëmarrës përmendën se ndërsa politikanët dhe udhëheqësit ushtarakë serbë u paditën nga ICTY, akuzat e politikanëve shqiptarë të Kosovës dhe të komandantëve të UÇK-së, lidhur me krimet e luftës, ishin të mangëta. Një ndjenjë akute e padrejtësisë së përjetuar nga viktimat serbe u shpreh fuqimisht nga shumica e pjesëmarrësve.

*“Të gjithë politikanët e nivelit të lartë dhe komandantët ushtarakë nga pala serbe janë akuzuar nga ICTY, ndërkohë që asnjëri nga shqiptarët e Kosovës nuk është paditur.” (burrë serb)*

*“Ka nevojë edhe për t'i përndjekur krimet kundër popullatës civile shqiptare të kryer nga UÇK-ja, për individët e akuzuar për bashkëpunim me serbë.” (burrë serb)*

*“Rezistenca e shqiptarëve ndaj themelimit të Gjykatës është e pritshme, pasi ajo do t'ua delegjitimizojë luftën për pavarësi.” (grua serbe) ♦*

# Analiza dhe rekomandime

Shtirja e ndikimit pozitiv shoqëror të arritur nga cilido mekanizëm ndërkombëtar ose hibrid i drejtësisë penale, në masë të madhe varet nga legjitimiteti i perceptuar i këtij institucioni në komunitetet e prekura. Perceptimi publik i legjitimitetit të gjykatave ndërkombëtare dhe hibride nuk mund të ndahet nga konteksti politik dhe shoqëror brenda të cilit ato themelohen. Rruga e gjykatave të tilla perceptohet si përzgjedhëse ose e pjesshme, mund të shfaqet një krizë e perceptimit publik (dhe, për rrjedhojë, një krizë legjitimiteti). Kjo, nga ana tjetër, mund të ketë ndikim të kundërt shoqëror dhe mund të dëmtojë proceset më të gjera të drejtësisë tranzicionale dhe të marrëdhënieve ndërmjet komuniteteve në konflikt.

Sa i përket Gjykatës Speciale të Kosovës, duhet nënvizuar se perceptimi i publikut nuk është kurrë statik dhe kushtëzohet nga zhvillimet kontekstuale; se Gjykata ende nuk ka lëshuar aktakuzat fillestare dhe se sapo të fillojë nga puna, perceptimi i performancës dhe indikimit të saj mund të zhvendoset; dhe së fundi, se ndjekja e drejtësisë penale në shoqëritë e ndara është në thelb delikate.

Për momentin, hulumtimi i perceptimit publik tregon se ndikimi pozitiv shoqëror mund të kufizohet nga dinamika politike dhe shoqërore në Kosovë, sidomos nga përvojat e mëparshme me përpjekjet ndërkombëtare dhe vendore për t'u marrë me të kaluarën që nuk përmbushën pritshmëritë, dhe nga konteksti politik kontravers i themelimit të Gjykatës; si dhe kuptimi i kufizuar i publikut për qëllimin dhe fushëveprimin e Gjykatës.

Hulumtimi tregon se vetëdijesimi i publikut për qëllimin, mandatin dhe fushëveprimin e Gjykatës Speciale të Kosovës është i ulët. Kjo i kontribuon përhapjes së keqinformimit (duke përfshirë narrativat nacionaliste që promovojnë mohimin dhe vetëviktimizimin në të dyja bashkësitë etnike), duke rritur gjasat e një efekti 'shokues' kur të lëshohen aktakuzat e para dhe duke zvogëluar gjasat e pranimit social të punës së gjykatës në afat të gjatë.

Hulumtimi tregon edhe se shumëkush nga bashkësia shqiptare e percepton mandatin e Gjykatës Speciale të Kosovës si përzgjedhës dhe të pjesshëm, ndërsa shumëkush nga bashkësia etnike serbe mbetet skeptik që ajo mund të sjellë drejtësi lidhur me rastet e krimeve të luftës të lëna mbas dore gjatë kohës, viktimat e të cilave ishin kryesisht serbë. Prandaj ekziston rreziku që, nëse puna e Gjykatës rezulton me ndjekjen e suksesshme të anëtarëve të UÇK-së, perceptimet e shqiptarëve për anshmërinë anti-UÇK në ndjekjen e rasteve të krimeve të luftës do të rriten. Nga ana tjetër, nëse Gjykata nuk është në gjendje të shqiptojë të paktën disa dënime, zhgënjimi i serbëve ndaj institucioneve të Kosovës do të rritet. Të dyja përfundimet do të kishin efekte negative në marrëdhëniet tashmë të tendosura mes komuniteteve shqiptare e serbe, në përpjekjet për të arritur pajtimin, dhe stabilitetin politik dhe social të Kosovës.

Rekomandimet e përvijuara më poshtë synojnë të adresojnë disa nga rreziqet e identifikuar nga anketimi i perceptimit publik dhe të forcojnë perspektivën e punës së Gjykatës Speciale të Kosovës që të japë ndikim pozitiv shoqëror. Rekomandimet përqendrohen në nevojën për (1) një program efikas, të bazuar në prova dhe të shënjestruar të informimit dhe të dialogut publik për të adresuar boshllëqet e informatave, për të luftuar keqinformimin dhe për të gjeneruar pranim të gjerë shoqëror të procesit dhe të rezultateve të tij; dhe (2) kontekstualizimin e punës së Gjykatës brenda një kuadri më të gjerë të përpjekjeve lokale, kombëtare e rajonale për ta trajtuar të kaluarën e kohës së luftës, për ta trajtuar perceptimin se ajo përfaqëson një ushtrim të njëanshëm të drejtësisë përzgjedhëse dhe maksimizon ndikimin pozitiv shoqëror.

Në rekomandime, përdoren termat e mëposhtëm:

- ◆ *palët e interesuara ndërkombëtare në Kosovë* i referohet Përfaqësuesit Special të BE-së / Ambasadorit të BE-së në Kosovë, EULEX-it, ambasadave të vendeve anëtare të BE-së, ambasadës së Shteteve të Bashkuara dhe sistemit të Kombeve të Bashkuara;
- ◆ *institucionet kyçe të BE-së* i referohet Përfaqësuesit Special të BE-së / Ambasadorit të BE-së në Kosovë, EULEX-it, Drejtorisë së Përgjithshme të Komisionit Evropian për Negocimet e Fqinjësisë dhe të Zgjerimit, Përfaqësuesit të Lartë të BE-së për Punët e Jashtme dhe të Sigurisë dhe Shërbimit Evropian të Veprimit të Jashtëm, si dhe Komitetit të Parlamentit Evropian për Punë të Jashtme dhe Raportuesit të Kosovës.

## Rekomandime

**Dhomat e Specializuara dhe Zyra e Prokurorit të Specializuar për Kosovën, Qeveria e Kosovës, palët e interesuara ndërkombëtare në Kosovë, institucionet kyçe të BE-së dhe shoqëria civile kosovare duhet:**

1. të bashkëpunojnë në zhvillimin dhe zbatimin e një **programi efektiv, të bazuar në prova dhe të shënjestruar të informimit dhe të dialogut publik**, duke përfshirë të gjitha palët kyçe dhe duke depërtuar te të gjitha komunitetet e ndryshme të Kosovës, për të:
  - ◆ adresuar boshllëqet e informacionit lidhur me arsyetimin për themelimin e Gjykatës Speciale të Kosovës, mandatin e saj dhe natyrën e pretendimeve të ngritura në raportin e Marty-t;
  - ◆ kundërshtuar në mënyrë proaktive keqinformimin, sidomos mitet rreth fushëveprimit dhe mandatit të Gjykatës, siç përshkruhet në këtë raport; dhe
  - ◆ nxitur të gjithë aktorët që të përdorin gjuhë të qëndrueshme kur shpjegojnë qëllimin, mandatin dhe proceset ligjore të Gjykatës; në mënyrë që të zbusin rrezikun e keqinterpretimit dhe hutisë dhe të gjenerojnë pranimin e gjerë social të procesit dhe rezultateve të tij.

2. të informojnë zhvillimin dhe zbatimin e aktiviteteve të informimit publik dhe të dialogut me **dëshmi të besueshme mbi perceptimin e publikut**, duke filluar me një studim të perceptimit publik bazë dhe duke vazhduar me anketat e rregullta vijuese, me qëllim që t'i rishikojnë rregullisht mesazhet kryesore, dhe të identifikojnë aleatët e mundshëm.

3. të përdorin mesazhe të **përshtatura për shqiptarët në Kosovë** që:

- ◆ vendosin punën e Gjykatës në një kontekst më të gjerë të implikimeve të saj për të ardhmen demokratike, shumetnike dhe evropiane të Kosovës
- ◆ mposhtin mohimin dhe vetëviktimizimin
- ◆ kryerrijojnë rrëfimet gjithëpërfshirëse për të kaluarën e kohës së luftës përgjithësisht
- ◆ ndërtojnë besim të gjerë dhe mbështetje për sundimin e ligjit duke theksuar rolin e Gjykatës për t'u siguruar se “askush nuk është përmbi ligjin”
- ◆ vendosin Gjykatën në raport me përpjekjet plotësuese lokale, kombëtare dhe rajonale për t'u marrë me të kaluarën e kohës së luftës në Kosovë, sidomos ato të ndërmarra nga Serbia ose në lidhje me të.

4. të përdorin mesazhe të **përshtatura për serbët në Kosovë** që:

- ◆ vendosin punën e Gjykatës në një kontekst më të gjerë të implikimeve të saj për të ardhmen demokratike, shumetnike dhe evropiane të Kosovës
- ◆ mposhtin mohimin dhe vetëviktimizimin
- ◆ kryerrijojnë rrëfimet gjithëpërfshirëse për të kaluarën e kohës së luftës përgjithësisht
- ◆ menaxhojnë pritshmëritë e viktimave dhe të bashkësive të prekura
- ◆ promovojnë parimin e përgjegjësisë individuale për krimet e luftës dhe krimet kundër njerëzimit të kryera kundër civilëve.

5. të përqendrohen për të shpjeguar qartë se si masat e mbrojtjes së dëshmitarëve në Gjykatën Speciale të Kosovës dallojnë nga ato që lidhen me praktikën gjyqësore të mëparshme kombëtare e ndërkombëtare, duke rritur kështu besimin e publikut dhe besimin e dëshmitarëve vetë.

6. të promovojnë **pjesëmarrjen e viktimave** si objektivi qendror i mesazheve dhe angazhimit.

7. të maksimizojnë shtrirjen e aktiviteteve të komunikimit publik duke përdorë **TV-në si media kryesore**, e plotësuar kjo me përfshirjen e drejtpërdrejtë me qytetarët përmes takimeve në bashkësi dhe veprimtari të tjera dialogu.

8. të përfshijnë një **strategji dalëse** që nga fillimi, duke siguruar që, kur Gjykata të nisë nga puna, veprimtaritë e informimit publik dhe të dialogut të ndërmerren nga shoqëria civile, bashkësia ligjore lokale dhe mediat lokale, me fonde dhe kapacitete përkatëse.

#### Dhomat e Specializuara të Kosovës dhe Zyra e Prokurorit të Specializuar duhet të:

9. vendosin një **prani domethënëse në jetën publike të Kosovës** në përkrahje të kontributeve për programin e informimit dhe dialogut publik të zhvilluar dhe të zbatuar në bashkërendim me palët e tjera të interesit, duke tejkaluar strategjinë e kufizuar të komunikimit publik për të arritur shikueshmëri, besueshmëri dhe **komunikimin të dyanshëm** që t'u mundësojë institucioneve dhe zyrtarëve të Gjykatës Speciale të Kosovës t'i ndikojnë pozitivisht rrëfimet në shoqërinë kosovare që aktivisht promovojnë mirëkuptimin dhe pranimin e punës së Gjykatës në një kontekst më të gjerë.

10. miratojnë një **kornizë për bashkëpunim të vazhdueshëm me shoqërinë civile kosovare**, duke kuptuar se bashkëpunimi i tillë është faktor kyç suksesi dhe se organizatat e shoqërisë civile mund të veprojnë si “hapës portash” për të fituar qasje të udhëheqësive dhe opinionistëve vendas dhe të shërbejnë si një përbërës jetik i një strategjie dalëse që vijon punën e informimit dhe dialogut publik pas përfundimit të procedurave gjyqësore.

#### Qeveria e Kosovës dhe palët kryesore ndërkombëtare në Kosovë duhet të:

11. përgatisin një **plan komunikimi për krizën**, duke u përqendruar në mesazhe të qarta nga udhëheqësit ndërkombëtarë dhe ish-prijësit e besueshëm të UÇK-së; dhe një **plan për emergjencën e sigurisë**, ekzistimi dhe aspektet e të cilëve duhet të bëhen publikë, duke treguar se ofruesit përkatës të sigurisë janë të përgatitur për mundësinë e dhunës, dhe të dhunës që e synon komunitetin serb dhe bashkësitë e tjera pakicë në veçanti.

#### Qeveria e Kosovës, me mbështetjen e palëve kyçe ndërkombëtare në Kosovë dhe të institucioneve kyçe të BE-së, duhet të:

12. investojë burime politike, burokratike dhe financiare për promovimin e një **kornize kombëtare për trajtimin e të kaluarës së luftës** që lehtëson perceptimet e përzgjedhshmërisë dhe padrejtësisë duke pozicionuar Gjykatën Speciale të Kosovës në raport me përpjekjet plotësuese lokale, kombëtare dhe rajonale për t'u marrë me të kaluarën e kohës së luftës në Kosovë, sidomos (por pa u kufizuar në):

- ◆ përfundimin e Strategjisë Kombëtare për Drejtësinë Tranzicionale
- ◆ diskutimet rreth Komisionit të propozuar për të Vërtetën dhe Pajtimin
- ◆ arritja e përparimit kuptimplotë në çështjen e personave të zhdukur
- ◆ nismat që promovojnë pranimin shoqëror të drejtësisë tranzicionale dhe rrëfimet gjithëpërfshirëse për të kaluarën e kohës së luftës në përgjithësi.

13. sigurohet që **të gjitha palët të bashkërendohen në komunikimin me përgjegjësi para qytetarëve**, duke pranuar të gjeturat se ish-komandantët e UÇK-së kanë besueshmëri më të lartë për të folur mbi çështjet rreth Gjykatës brenda bashkësisë shqiptare dhe se prandaj kanë rol jetik për të luajtur duke folur me përgjegjësi ndaj çështjeve rreth punës së Gjykatës, pavarësisht se kush e udhëheq qeverinë që do të formohet pas zgjedhjeve të qershorit 2017.

#### Udhëheqësit politikë serbë në Kosovë dhe Qeveria e Serbisë duhet të:

14. **ushtrojnë përgjegjësi dhe kujdes** kur komentojnë veprimet e Gjykatës Speciale të Kosovës, sidomos aktakuzat dhe aktgjykimet, në mënyrë që të mos politizojnë pa nevojë punën e Gjykatës ose të kontribuojnë në përkeqësimin e marrëdhënieve ndërmjet komuniteteve në Kosovë ose kushteve të sigurisë për bashkësinë serbe në Kosovë. ◆

#### Për informata dhe kërkesa shtesë, ju lutem kontaktoni:

Michael James Warren, Menaxher programi

PAX (Holandë)

[www.paxforpeace.nl](http://www.paxforpeace.nl) | [warren@paxforpeace.nl](mailto:warren@paxforpeace.nl)

Kushtrim Koliqi, Drejtor ekzekutiv

Integra (Kosovë)

[www.ngo-integra.org](http://www.ngo-integra.org) | [kushtrim.koliqi@ngo-integra.org](mailto:kushtrim.koliqi@ngo-integra.org)

Nenad Maksimović, Drejtor ekzekutiv

Centre for Peace and Tolerance (Kosovë)

[www.ngocpt.org](http://www.ngocpt.org) | [nenad.maksimovic@ngocpt.org](mailto:nenad.maksimovic@ngocpt.org)

Marlies Stappers, Drejtor ekzekutiv

Impunity Watch (Holandë)

[www.impunitywatch.org](http://www.impunitywatch.org) | [marlies.stappers@impunitywatch.org](mailto:marlies.stappers@impunitywatch.org)



Sint Jacobsstraat 12  
3511 BS Utrecht  
The Netherlands

[www.paxforpeace.nl](http://www.paxforpeace.nl)  
[info@paxforpeace.nl](mailto:info@paxforpeace.nl)  
+31 (0)30 233 33 46

P.O. Box 19318  
3501 DH Utrecht  
The Netherlands